

*Të Gëzojmë*  
**THESARET**  
*e Natyrës Sonë*

NJË MODEL PARAROJË PËR  
ZHVILLIMIN E TURIZMIT TË  
QËNDRUESHËM NË  
BREGDETIN SHQIPTAR



**PPNEA**


Protection and Preservation of Natural Environment in Albania

**CRITICAL** | **ECOSYSTEM**  
**PARTNERSHIP FUND**





Shqipëria gëzon një diversitet biologjik mjaft të pasur dhe një larmi peisazhesh natyrore të mrekullueshme. Zonat e Mbrojtura përbëjnë përafërsisht 17% të territorit të Shqipërisë dhe kjo sipërfaqe pritet të rritet në të ardhmen. Këto zona për shkak të vlerave të mëdha natyrore, përfaqësojnë në të njëjtën kohë një potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin social-ekonomik të komuniteteve lokale nëpërmjet aktiviteteve të qëndrueshme.



## QËLLIMI DHE PËRAFRIMI I PROJEKTIT

Përgjatë një periudhe tre vjeçare, filluar në korrik 2013, projekti do të kontribuojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm natyror në tre zona kyç të biodiversitetit që janë përcaktuar përgjatë bregdetit Shqiptar të jugut. Qëllimi i këtij projekti do të arrihet nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës të aktorëve kyç vendorë dhe më gjerë.

## REZULTATET E PRITURA

- Pëmirësimi i infrastrukturës turistike në zonat e veprimit të projektit
- Promovimi i gjerë i vlerave turistike të këtyre zonave
- Zhvillimi i aktiviteteve fitimprurëse të qëndrueshme
- Rritja e kapaciteteve të aktorëve kyç vendorë në përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore
- Nxitja e rjetëzimit të grupeve vendorë të interesit për të punuar për mbrojtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik

# ZONAT E VEPRIMIT TË PROJEKTIT

## LAGUNA E NARTËS DHE ZONA PËRRETH



Laguna e Nartës përfaqëson një nga zonat me të rëndësishme në Shqipëri përsa i përket numrit të habitateve, dhe ndjeshmërisë mjedisore. Shumë specie bimore të zonës janë të përfshira në librin e Kuq të Specieve të Shqipërisë. Laguna e Nartës, konsiderohet si habitat i dytë më i rëndësishëm në Shqipëri për shpendët ujorë dhe është vendi kryesor në Shqipëri për Flamingon e kuq (*Phoenicopterus ruber*), Gjëlzën pikaloshë (*Pluvialis squatarola*), Laroshen (*Tadorna tadorna*), Vrapuesin gushëbardhë (*Charadrius alexandrinus*), Rosën me katër sy (*Buchepala clangula*) etj. Në Nartë është gjithashtu i pranishëm edhe Pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*).

## GJIRI I VLORËS KARABURUN - MALI I ÇIKËS



Kjo zonë përmban një larmi peisazhesh natyrore të mrekullueshme bregdetare dhe malore. Është një zonë kyç për shumë specie endemike dhe relike të periudhës terciare si *Hypericum haplopyloides*, *Leucojum valentinum*, *Taxus baccata*, *Quercus ithaburensis* etj. Lakuriqët e natës, gjitarët e mëdhenj tokësorë, dhe ata ujorë e detarë, duke përfshirë këtu të tre llojet e delfinëve Europianë, lundërzën, dhe fokën e detit janë gjithashtu të pranishëm në këtë zonë.

## BUTRINTI DHE ZONA PËRRETH



Butrinti, përveç se zonë UNESCO e trashëgimisë botërore, është dhe vendi më i rëndësishëm në Shqipëri përsa i përket numrit të amfibëve, reptilëve, dhe shpendëve. Është i vetmi vënd në Shqipëri ku gjendet Bretkosa Epirote (*Rana epirotica*), Breshka me samar të skajëzuar (*Testudo marginata*), Bolla e rërës (*Eryx jaculus*) dhe Hardhuca Ballkanase e mureve (*Podarcis taurica jonica*). Është gjithashtu një nga vëndet që përmban numrin më të madh të gjitarëve në Shqipëri.





# PPNEA

Protection and Preservation of Natural Environment in Albania

**CRITICAL ECOSYSTEM  
PARTNERSHIP FUND**



Shoqata e Ruajtjes dhe e Mbrojtjes  
së Mjedisit Natyror në Shqipëri

Rruga, Vangjush Furrxhi  
Pall. 16, Shk 1, Ap 10, Tirana, Albania  
Phone/Fax: +355 4 2256 257  
e-mail: [contact@ppnea.org](mailto:contact@ppnea.org)  
**[www.ppnea.org](http://www.ppnea.org)**

DONATORI:  
Fondi i Partneritetit për  
Ekosistemet Kritike (CEPF)

Fondi i Partneritetit për Ekosistemet Kritike  
është një nismë e përbashkët e Agjensisë  
Franceze të Zhvillimit, Bashkimit Europian,  
Fondit Botëror për Mjedisin, Qeverisë  
Japoneze, Fondacionit MacArthur si dhe  
Bankës Botërore

PARTNERET NË IMPLEMENTIM

Shoqëria Bullgare për Mbrojtjen e  
Shpendëve, anëtare e Birdlife International